

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale për nënstacione”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31681000-3 - Pajisje elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT:

134,813,855 (njëqind e tridhjetë e katër milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 1,465,367.9 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 10.09.2026 (1 EUR = 92 Lekë).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisjesh për Nënstacione”, ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me disa pajisje të cilat përdoren për mirëmbajtjen e Nënstacioneve, në funksion të veprimtarisë së punës së AK.

Referuar procedurës së prokurimit, AK vlereson se kjo procedure prokurimi nuk mund të ndahet në Lote, pasi krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë përdorshmëri të perkohshme ose vonesa të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund të disponojë një element nga mallrat objekt prokurimi në vetë dhe të presë furnizimin e mallrave të tjera, në qoftë se këto janë të ndara në lote.

Gjithashtu, vonesat që mund të shkaktohen nga marrëdhënia e me disa operatore ekonomike mund të vështiresojë edhe nevojat e AK për ushtrimin e funksionit të saj, dhe mund të krijohen probleme në linjat e transmetimit të energjisë elektrike.

AK është një institucion i rëndësishëm në sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe gjithashtu ben edhe lidhjet e nevojshme me vendet fqinje dhe për këtë arsye.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, jo më të vogël se 200,000,000 (dyqind milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e sipërpërmendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jetë në masën 200,000,000 (dyqind milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 48,500,000 (dyzet e tetë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 36 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë 36 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar per mallrat objekt prokurimi, si vijon:*

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia
1	Kontaktet rrëshkitëse për thika 400 kV	Copë
2	Morseta të ndryshme për CT, VT dhe percjellës linje.	Copë
3	Shkarkues 1.5 deri 5 kV te montuar në “Linkbox”	Copë
4	TR rryme 400 kV, koeficient 1200-2400/1A	Copë
5	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/5A	Copë
6	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/1A	Copë
7	TR Tensioni 110 kV	Copë
8	Transformatorët Instrumental të kombinuar të Matjes 123 kV	Copë
9	Çelës me gaz SF6 220 kV 3-polar 110 VDC	Copë
10	Çelsa me gaz SF6,110 kV 220 VDC	Copë
10A	Çelsa me gaz SF6,110 kV 110VDC	Copë
11	Transformator për nevojat vetjake 250 kVA, 35/0.4 kV	Copë
12	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
12A	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
13	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
13A	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
14	Thika me një thike toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
14A	Thika me një thike toke 110 kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
15	Thika me dy thika toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
16	Sallë baterish 220 VDC	Set
17	Aparature laboratorike automatike per testimin e vajit (tensionit te shpimit te vajit)	Copë
18	Mbrojtjet Distancionale për linjat e tensionit të lartë.	Copë
19	Rele e kontrollit për linjat BCU	Copë
20	DC/DC CONVERTER 220/110 VDC, 2200W	Copë
21	Multimetra per panele komandimi	Copë
22	Pjesë rezerve për çelësat 220 dhe 110kV (sipas specifikimeve teknike)	komplet

Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit per te gjithë mallrat objekt prokurimi, si vijon:*

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia
1	Kontaktet rrëshkitëse për thika 400 kV	Copë
4	TR rryme 400 kV, koeficient 1200-2400/1A	Copë
5	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/5A	Copë
6	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/1A	Copë
7	TR Tensioni 110 kV	Copë
8	Transformatorët Instrumental të kombinuar të Matjes 123 kV	Copë
9	Çelës me gaz SF6 220 kV 3-polar 110 VDC	Copë
10	Çelsa me gaz SF6,110 kV 220 VDC	Copë
10A	Çelsa me gaz SF6,110 kV 110VDC	Copë
11	Transformator për nevojat vetjake 250 kVA, 35/0.4 kV	Copë
12	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
12A	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
13	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
13A	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
14	Thika me një thike toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
14A	Thika me një thike toke 110 kV (tre fazor) 220 VDC	Copë
15	Thika me dy thika toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë
16	Sallë baterish 220 VDC	Set
17	Aparature laboratorike automatike per testimin e vajit (tensionit te shpimit te vajit)	Copë
18	Mbrojtjet Distancionale për linjat e tensionit të lartë	Copë
19	Rele e kontrollit për linjat BCU	Copë
20	DC/DC CONVERTER 220/110 VDC, 2200W	Copë
21	Multimetra per panele komandimi	Copë
22	Pjesë rezerve për çelësat 220 dhe 110kV (sipas specifikimeve teknike)	komplet

Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, duhet te tregojne lehtesisht dhe se cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 **TABELA E ARTIKUJVE/MALLRAVE**, paraqitur nga Autoriteti Kontraktor me poshte, duhet te plotesohet rigorozisht nga Ofertuesi, per te gjithë artikujt e tabelës që kerkohet. Te kjo tabelë nga ofertuesi duhet te plotesohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. i faqes se ketij katalogu si dhe Nr. references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali i prodhuesit, per te gjithë ato artikuj që kerkohen ne kete tabelë:

Plotesuar nga AK				Duhet te plotesohet nga OE			
Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Emri i kompanisë prodhuese	Emertimi i katalogut te artikullit / produktit	Nr. i faqes se katalogut	Nr. references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali/katalogu i prodhuesit
1	Kontaktet rrëshkitëse për thika 400 kV	Copë					
4	TR rryme 400 kV, koeficient 1200-2400/1A	Copë					
5	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/5A	Copë					
6	TR rryme 110kV, koeficient 300-600/1A	Copë					
7	TR Tensioni 110 kV	Copë					
8	Transformatorët Instrumental të kombinuar të Matjes 123 kV	Copë					
9	Çelës me gaz SF6 220 kV 3-polar 110 VDC	Copë					
10	Çelsa me gaz SF6,110 kV 220 VDC	Copë					
10A	Çelsa me gaz SF6,110 kV 110VDC	Copë					
11	Transformator për nevojat vetjake 250 kVA, 35/0.4 kV	Copë					
12	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë					
12A	Thika me një thike toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë					
13	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 110 VDC	Copë					
13A	Thika me dy thika toke 220kV (tre fazor) 220 VDC	Copë					
14	Thika me një thike toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë					
15	Thika me dy thika toke 110 kV (tre fazor) 110 VDC	Copë					
16	Sallë baterish 220 VDC	Set					
17	Aparature laboratorike automatike per testimin e vajit (tensionit te shpimit te vajit)	Copë					
18	Mbrojtjet Distancionale për linjat e tensionit të lartë	Copë					
19	Rele e kontrollit për linjat BCU	Copë					
20	DC/DC CONVERTER 220/110 VDC, 2200W	Copë					
21	Multimetra per panele komandimi	Copë					

22	Pjesë rezerve për çelësat 220 dhe 110kV (sipas specifikimeve teknike)	komple t					
----	---	----------	--	--	--	--	--

Pershkrimi i katalogut duhet te perputhet me specifikimet teknike te kerkuara per mallrat objekt prokurimi.

Mosplotesimi korrekt i tabelës, eshte element skualifikues.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe ka lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:

➤ *ISO 9001: Për sistemin e menaxhimit të cilësisë.*

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktesisht kolonat me te dhenat teknike te ofertuar ne te gjitha tabelat e paraqitura ne shtojcen 6 (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve.

Mosplotesimi i sakte eshte element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr

përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Ates, Amesi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoren e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, ates, amesi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasinë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.